



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2020:014358

Datë: 08.06.2020

Numri i dokumentit: 00948672

**Pnr. 101/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA VUSHTRRI**, Gjyqtari Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e sekretari juridik - praktikanti Agon Balinca, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarit M.B.i nga fsh. S. komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale Vjedhje e Shërbimeve nga neni 314 par 1 lidhur me par 6 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II-nr.105/20 dt: 22.01.2020, dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të paraqitur në të njëjtën aktakuzë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, në mbështetje të nenit 495 të KPPK-së, me datë 19.02.2020, nxjerre këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe jepet:

### **URDHËRI NDESHKIMOR**

#### **Kundër të akuzuarit:**

**M. B.i**, nga i ati A., i lindur me ....., me vendbanim ne fsh. S.-komuna Vushtrri, me nr. personal .....me nr unik te shpenzuesit DMI: 9044426 Kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** me datën 12.01.2019. ne shtëpinë e tij ne fshatin S.. Ka shfryzuar shërbimet për te cilat e di se janë te disponueshme vetëm ne këmbim te pagesës, dhe iu është shmangur pagesës, ne atë mënyre qe pa autorizimin e furnizuesit te autorizuar KEDS ka shfryzuar energjinë elektrike duke u kyç direkt ne kablllo ne bander, duke anashkaluar njehsorin , ne mënyre te kundërligjshme e ka shpenzuar energjinë elektrike duke i shkaktuar KEDS –it dem ne vlere prej 159.96 euro, qe është vërtetuar me vështrimin ne terren ne ditën e cekur nga ana e zyrtareve te autorizuar te KEDS-it

**Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par .1 lidhur me par 6 të KPRK- së.**

Andaj gjykata komfortë dispozitave të neneve 38, 43, 48, 69 dhe nenit 314 te KPRK-së dhe nenit 365 e 495 të KPPK-ës, i shqipton :

### **DENIM ME KUSHT**

Me te cilin te akuzuarit i vërtetohet dënimi me gjobe ne shumë prej 100 (njëqind) euro, i cilin dënim-gjobë, nuk do te ekzekutohet ne afat prej 1 viti ne qofte se i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**OBLIGOHET** i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale –paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20€**,te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**DETYROHET** i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-se ti' a paguaj demin e shkaktuar ne shumën prej 159.96

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën nr. , PP.II-nr.105/20dt: 22.01.2020, po ashtu është parashtruar edhe kërkesa për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, kundër te pandehurit M.B. për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve publike nga neni 320 par .1 të KPRK- së.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar ne baze te nenit 495 te KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, pasi qe nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e te akuzuarit se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas Aktakuzës se Prokurorit te Shtetit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat te cilat janë të mjaftueshme e për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës se prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë dhe atë: Procesverbal i KEDS-it i datës 12.11.2019, fotodokumentacioni i (3) foto, Kalkulimi i RH i datës 13.11.2019 si dhe Faktura e KEDS-it e datës 13.11.2019

Sipas KPRK-se, për vepra penale – Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 1 lidhur me par 6 të KPRK-ës, dënimi për këtë vepër penale është dënim me gjobë ose burgim deri në tre (3) vite.

Gjykata në përputhje me nenin 69 të KPRK-se, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoj rrethanat ne matjen e dënimit, duke vlerësuar se një dënim i tille është adekuat dhe është i përballueshëm për të akuzuarin në raport me gjendjen e tij ekonomike dhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 te KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori komform nenit 450 të KPP-ës.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE DEGA VUSHTRI** **Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal** **P.nr.101/20 dt.19.02.2020**

**Sekretari juridik- Praktikanti**  
**gjkues**  
**Agon Balinca**

**Gjyqtari i vetëm**  
**Ferki Xhaferi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afate prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate.